



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh. II.nr.1264/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Eletrike Sh.a. (KESco), bulevardi Bill Klindton, Nr.5, Ndërtesa Elektrokosova, Kati II, Prishtinë me numër të Biznesit 71102130, kundër debitorit Furra Evropa Xh.H. (B.F.), Adresa Xërxë, Rahovec, nr. personal ..., me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.550/22 të datës 27.06.2023, me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Eletrike Sh.a. (KESco), ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.550/22 të datës 27.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.550/22 të datës 27.06.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Xh.H. i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.197/19 të datës 19.04.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të prishet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.550/22 të datës 27.06.2023 dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Eletrike Sh.a. (KESco), ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë dokumentit të besueshëm - Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit për periudhën 04.04.2013 deri me datën 13.03.2019, me të cilin e ka obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të Urdhrit t'ia paguajë kreditorit borxhin prej 1,129.02 € në emër të borxhit kryesor me kamatë 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit, dhe shpenzimet e këtij ekzekutimi në llogaritë e cekura si në këtë urdhër, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve monetare të cilat i ka debitori në llogarinë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë Bankare të Kreditorit, ndalimin e mjeteve në të ardhura personale ose Regjistrimi, vlerësimi, sekuestrimi ose shitja e sendeve të luajtshme, deri në vlerën e borxhit.

Debitori, i nënshkruar si Xh.H. në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se ai nuk është pronar i furrës Evropa por, pronar është B.F.. Ai shtoi se nuk e din se nga është marr emri i tij duke i propozuar Gjykatës që ta shfuqizoj urdhrin sa i përket emrit të tij, dhe se njëherit ky borxh është parashkruar. Tutje theksoi se banon në Gjakovë dhe jo në Xërxë dhe se propozimi për përmbarim nuk është i rregullt sepse nuk përmban numër të biznesit të firmës. Prapësimi i ka bashkangjitur Regjistrin për deklarimin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit për Xh.H. dhe Kartelën financiare të KRU Radoniqi ku figuron B.F. pronarë i dyqanit Evropa në Xërxë.

Kreditori në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara dhe të paargumentuara me asnjë provë me arsyetimin se në kartelën e të dhënave të konsumatorit dëshmohet se njehsori me shifër të konsumatorit 80016295 është në emër të Xh.H. të dhëna personale vet debitori i ka prezantuar me rastin e regjistrimit të njehsorit. Shtoi se debitori në prapësimin e tij është vet kontradiktor pasi që fillimisht kërkon nga Gjykata që ta shfuqizoj urdhrin e përmbaruesit privat me pretendim se nuk është debitor, ndërsa në anën tjetër thirret në parashkrimin e borxhit për të cilin pretendon se nuk e ka krijuar. Tutje shtoi se debitori me datë 19.10.2018 ka bërë pagesë në vlerë prej 25.00 € dhe se me këtë pagesë vullnetare ex lege ndërpritet parashkrimi konform nenit 368 të LMD-së. Andaj propozoi që të mbetet në fuqi Urdhri i përmbaruesit privat për caktimin e përmbarimit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.550/22 të datës 27.06.2023 e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Xh.H. i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.197/19 të datës 19.04.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se propozimi për përmbarim i kreditorit nuk i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin e lartcekur 38 të LPP-së, për faktin se në propozim mungojnë të dhënat e plota mbi debitorin ashtu që ceket se debitori është Furra Evropa, pa numër të biznesit, ndërsa figurojnë dy persona Xh.H. dhe B.F. dhe një numër personal i cili sipas prapësimit të Xh.H. vlerësohet së është numri personal i Xh.H.. Sipas të dhënave nga ARBK, nuk figuron ndonjë biznes me emër Furra Evropa në Rahovec, Xërxë. Andaj, duke qenë së përmbaruesi privat nuk ka vepruar konform nenit 38 par 2 i LPP-së, ashtu që ti kthej kreditorit propozimin për plotësim, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Me shikim në ekstraktin nga librat e kontabilitetit të Kru Radoniqi e bashkangjitur nga debitori Xh.H., figuron emri i “B.F.- Europa Xerxe DYQ”.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se në propozim mungojnë të dhënat e plota mbi debitorin ashtu

që ceket se debitori është Furra Evropa, pa numër të biznesit, andaj, në mungesë të dhënave të sakta lidhur me biznesin është aprovuar urdhri përmbartimor, sepse edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykatë përmbartuesi privat nuk ka vepruar konform nenit 38 par 2 i LPP-së, ashtu që ti kthej kreditorit propozimin për plotësim.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Dhoma e shkallës së dytë vlerësoj pretendimet ankimore të kreditorit mirëpo meqë propozimi për përmbartim në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 38 të LPP-së, vendosi që aktvendimin e ankimuar ta vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.Sh II.nr. 1264/23 , datë: 22.04.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri